



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E martë, 2 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 19.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00–2015–3077 (368), datë 16.9.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 11379
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 19.7.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë..... 11382
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 12828, datë 20.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3980, datë 18.12.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00–2015–2565, datë 16.7.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... 11387
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 22.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 5, datë 12.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë..... 11394
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 48, datë 22.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 309, datë 27.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 09, datë 16.9.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00–2014–1066, datë 4.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 11398
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 22.7.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00–2014–721 (153), datë 25.2.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 11401
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 154, datë 18.7.2016	Mbi miratimin e ndryshimit të pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv, miratuar me vendimin nr. 4, datë 22.5.2013, “Mbi miratimin e pagesave për licencë” 11408



VENDIM
Nr. 44, datë 19.7.2016
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 2.6.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 25 Akti, që i përket:

KËRKUES: Frensis Qazolli

SUBJEKTE TË INTERESUAR: Shoqëria e Sigurimeve “Atlantik” sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 6 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar në datën 19.6.2010, gjatë drejtimit të mjetit tip “Audi” me targë TR8609P, është përfshirë në një aksident automobilistik në Tiranë. Sipas procesverbalit të Policisë Rrugore rezulton se shkak i aksidentit ka qenë mosrespektimi i nenit 139/2 të Kodit Rrugor, sepse ka humbur kontrollin e mjetit dhe ka goditur bordurën e urës, duke e dëmtuar rëndë atë dhe duke përfunduar në kanal.

2. Mjeti tip “Audi” me targë TR8609P ka qenë i siguruar me kontratë sigurimi kasko nr.

010865, datë 19.5.2010. Për këtë arsye kërkuar i është drejtuar subjektit të interesuar, shoqërisë së sigurimeve “Atlantik” sh.a., me kërkesë për dëmshpërblim. Kjo e fundit ka refuzuar dëmshpërblimin, pasi, sipas saj, shkak i aksidentit i përcaktuar nga Policia Rrugore lidhej me nenin 139 të Kodit Rrugor, që parashikon *shpejtësinë* gjatë drejtimit të mjetit dhe aksidentet e ndodhura për këtë shkak nuk mbulohen nga shoqëria e sigurimit sipas rubrikës “Përjashtime” të kontratës së sigurimit.

3. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt shpërblimin e plotë të dëmit sipas kontratës së sigurimit kasko nr. 010865 për mjetin tip “Audi” me targë TR8609P të dëmtuar si pasojë e aksidentit automobilistik të datës 19.6.2010, si dhe kamatat e arrira të shumës së paakorduar në kohë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7047, datë 19.9.2011, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurit “Atlantik” sh.a. që t’i paguajë paditësit Frensis Qazolli shumën prej 19.200 eurosh si detyrim kontraktor të papaguar që rrjedh nga polica e sigurimit kasko nr. 010865, datë 19.5.2010.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1963, datë 19.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kundër vendimit nr. 1963, datë 19.7.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë ka ushtruar rekurs subjekti i interesuar, shoqëria “Atlantik” sh.a.. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1963, datë 19.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Frensis Qazolli.

II

6. Kërkuar Frensis Qazolli i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1 Është cenuar *parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë,



duke bërë interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara dhe vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, ka vepruar tej kompetencave të tij. Arsyetimi i vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bie ndesh me provat e administruara dhe të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

6.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me ligjin material, pasi interpretimi që ajo ka bërë lidhur me nenin 139/2 të Kodit Rrugor, kontratën e sigurimit kasko dhe nenet 1113 e vijues të Kodit Civil (KC) është i gabuar. Gjykata e ka shqyrtuar procesverbalin e konstatimit të shkeljes duke iu referuar nenit 139 të Kodit Rrugor.

6.3 Gjykata e Lartë me vendimin e saj ka vlerësuar e zbatuar gabim nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sepse rekursi nuk përmban asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për shqyrtimin gjyqësor të tij.

6.4 Gjykata e Lartë nuk ka respektuar nenet 12, 29 dhe 309 të KPC-së. Kjo ka sjellë humbjen e besimit në objektivitetin dhe paanshmërinë e dhënies së vendimit të drejtë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuari, *prima facie*, legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për themelin e çështjes

B.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

9. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji

Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ato dhe duke tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Procesi konsiderohet i rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese rezulton se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi



mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin në shqyrtim, nga aktet bashkë-lidhur kërkesës, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur se “Gjykata çmon se në kontratën e sigurimit kasko është parashikuar si rast përjashtimor që i humbet të drejtën të siguruarit, tejkalimi nga ana e këtij të fundit (përdoruesit të mjetit) të normave të shpejtësisë. Nga ana tjetër, dispozita e cituar nga policia rrugore si shkak i aksidentit është neni 139/2 i Kodit Rrugor, i cili ndonëse përfshihet te një nen që titullohet “Shpejtësia”, gjithësesi parashikon se “2. Drejtuesi i mjetit duhet të ruajë gjithmonë kontrollin e mjetit dhe të jetë në gjendje të kryejë të gjitha manovrat e nevojshme në kushte të sigurta, veçanërisht frenimin e menjëhershëm të mjetit brenda kufijve të fushëpamjes dhe përpara çdo pengese të mundshme.”.

Nga procesverbalin e policisë rrugore nuk rezulton të jetë përcaktuar shpejtësia me të cilën ka qenë mjeti në momentin e humbjes së kontrollit nga drejtuesi i saj. Kësisoj, nuk mund të konkludohet nëse shkak i ndodhjes së aksidentit ka qenë tejkalimi i normave të shpejtësisë nga drejtuesi i mjetit tip “Audi”, por duhet pranuar versioni i thënë në procesverbalin e konstatimit të shkeljes (akt zyrtar me fuqi të plotë provuese) se aksidenti ka ndodhur si rrjedhojë e humbjes së kontrollit mbi mjetin nga drejtuesi i tij, pa u lidhur ky fakt me tejkalimin e shpejtësisë. Humbja e drejtimit të mjetit mund të ndodhë për shumë shkaqe dhe tejkalimi i shpejtësisë mund të jetë vetëm njëri prej tyre. Për sa kohë që nuk përcaktohet dot ky parashikim kontraktor, atëherë mbi palën e paditur rëndon detyrimi i pagimit të shumës sipas policës së sigurimit kasko.”.

14. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1963, datë 19.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 7047, datë 19.9.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me arsyetimin: “Në kushtet kur pala e paditur në gjykim nuk ka arritur të provojë rastin përjashtimor të mbulimit të kontratës së sigurimit dhe për sa kohë nuk përcaktohet dot ky parashikim kontraktor, por vetëm mbetet në kuadrin e prapësimeve, atëherë drejt Gjykatës së Rrethit ka arritur në përfundimin se mbi palën e paditur rëndon detyrimi i pagimit të shumës sipas policës së sigurimit kasko. Në këto rrethana, ndryshe sa pretendohet

në ankim se gjykata ka zbatuar gabim ligjin material, me provat e paraqitura në gjykim ka rezultuar se padia e paditësit Frensis Qazolli të jetë e mbështetur në ligj, nenet 419, 420 etj. 1137 të Kodit Civil, prandaj vendimi i Gjykatës së Rrethit nuk ka vend që të bëhet i cënueshëm.”.

15. Ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar se “duke qenë se paditësi Frensis Qazolli ka kryer një kundërvajtje administrative (shkelje me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim), e cila është parashikuar shprehimisht në nenin 139§2 të Kodit Rrugor, i cili titullohet “Shpejtësia” dhe për këtë shkelje paditësi është ndësbkënuar me gjobë në masën dy mijë lekë (neni 139§10 i Kodit Rrugor), atëherë ngjarja e ndodhur nuk përfshihet në rastet e sigurimit të parashikuara nga ana e palëve ndërgjyqëse në Kontratën e Sigurimit Kasko, pasi në këtë kontratë, në rubrikën “Përjashtime” të Kushteve të Përgjithshme, është përcaktuar shprehimisht se siguruesi nuk mbulon “dëmet si rezultat i tejkalimit të normave të shpejtësisë ... dhe/ose për shkak dhe neglizhencë të rëndë të të siguruarit.”.

16. Gjykata Kushtetuese është shprehur se nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë a priori nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit, por në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Edhe në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil ka rivlerësuar provat e administruara e të vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil ka arsyetuar se shkak i aksidentit ka qenë tejkalimi i shpejtësisë, pavarësisht se kjo nuk provohet në vendimet e gjykatave më të ulëta të bazuara në një



akt zyrtar, procesverbalin e mbajtur nga Policia Rrugore. Gjykata e Lartë edhe pse nuk ka vënë në dyshim vlerën e këtij akti zyrtar, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të faktit dhe për rrjedhojë të provave, duke ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta.

18. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime për shkëlqen e rregullave të qarkullimit rrugor si pasojë e shpejtësisë së madhe, duhet të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit duke dhënë udhëzimet përkatëse në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtuar provat hetimit të plotë gjyqësor. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj¹.

B.2 Në lidhje me pretendimet e tjeru

19. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim me ligjin material, pasi interpretimi që ka bërë ajo gjykatë lidhur me nenin 139/2 të Kodit Rrugor dhe nenet 1113 e vijues të Kodit Civil është i gabuar. Gjithashtu, sipas kërkuesit, Kolegji Civil ka kryer shkelje procedurale, sepse ka zbatuar gabim nenet 12, 29, 309 dhe 472 të KPC-së, çka ka sjellë humbjen e besimit në objektivitetin e dhënies së një vendimi të drejtë.

20. Referuar natyrës ligjore të këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se çështjet e pretenduara nga kërkuesi i takojnë juridiksionit të zakonshëm dhe jo kategorisë së çështjeve që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin

konkret Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3077 (368), datë 16.9.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo

Anëtarë kundër: Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 45, datë 19.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 35 Akti, që i përket:

¹ Gjyqtarët V. Kristo dhe G. Dizdari votuan për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka atribuar vetes kompetenca të pa autorizuara nga ligjvënësi sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 35, datë 27.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.



KËRKUES: Vehab Aliu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Tiranë, Shoqëria Përmbartimore “JUS” sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Bashkia Tiranë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e Bashkisë Tiranë të vijojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të tij, që shtrihet në pasuritë e paluajtshme nr. 5/17 dhe nr. 5/603, me sipërfaqe totale 270 m² dhe ndërtesë 101.5 m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8360, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 937, datë 25.2.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e subjektit të interesuar, Bashkia Tiranë, të vijojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të kërkesit, si dhe të përmbushë detyrimet ndaj tij, duke përfshirë shpenzimet gjyqësore, të cilat përfshijnë shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifën për vënien në ekzekutim.

3. Vendimi i Gjykatës Administrative të

Shkallës së Parë Tiranë nr. 937, datë 25.2.2015 ka marrë formë të prerë në datën 12.3.2015, pasi nuk është ankimuar nga subjekti i interesuar Bashkia Tiranë.

4. Me shkresën e datës 2.4.2015, kërkuesi i është drejtuar Bashkisë Tiranë për ekzekutimin vullnetar të këtij vendimi.

5. Duke qenë se Bashkia Tiranë nuk ka marrë asnjë masë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të lartpërmendur, në datën 8.5.2015 kërkuesi i është drejtuar shoqërisë përmbartimore “Jus” sh.p.k. për vënien në ekzekutim të tij.

6. Me shkresën nr. 761/1 prot., datë 12.5.2015 shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k. i ka kërkuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015, ndërsa me shkresën nr. 761/2 prot., datë 25.5.2015, ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit *de quo*.

7. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015, në përgjigje të shkresave të sipërcituara, në zbatim të VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri në 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, i ka bërë me dije kërkesit se për të vënë në ekzekutim kërkesën e tij, ky i fundit duhet të depozitonte pranë saj (Bashkisë) dokumentacionin që provon plotësimin e kushteve të kërkuara nga VKM-ja.

8. Duke qenë se subjekti i interesuar Bashkia Tiranë nuk ka vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, me shkresën nr. 761/3 prot., datë 29.10.2015, shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k., në zbatim të neneve 519, 523, 527 dhe 589 të KPC-së, i ka rikujtuar Bashkisë Tiranë ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9. Pavarësisht shkresave të lartpërmendura, subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, nuk e ka ekzekutuar vendimin e formës së prerë.

II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm



nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

11. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

11.1. Kryetari i Bashkisë Tiranë, bazuar në VKM-në nr. 608, datë 5.9.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri në 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, me urdhrin nr. 271, datë 25.2.2013 dhe urdhrin nr. 6301, datë 29.4.2014, ka vendosur ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012. Këto grupe pune kanë për qëllim shqyrtimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të depozituar nga individët sipas procedurës së përcaktuar në VKM-në e lartpërmendur.

11.2. Bashkia Tiranë nuk e ka ekzekutuar vendimin e formës së prerë sepse vetë kërkuesi ka qenë pengesë në zbatimin e tij, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave, sikurse i është bërë me dije edhe shoqërisë përmbartimore me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015.

12. **Subjekti i interesuar, shoqëria përmbartimore “JUS” sh.p.k.**, në prapësimet me shkrim të depozituara ka paraqitur një kronologji të veprimeve përmbartimore e konkretisht:

12.1. Me shkresën nr. 761/1 prot., datë 12.5.2015, shoqëria përmbartimore “Jus” sh.p.k. i ka kërkuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015; me shkresën nr. 761/2 prot., datë 25.5.2015 i ka kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë; me shkresën nr. 761/3 prot., datë 29.10.2015, në zbatim të neneve 519, 523, 527 dhe 589 të KPC-së, i ka rikujtuar subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të

Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 17, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po ashtu, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, në jurisprudencën kushtetuese është konsideruar tashmë si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Për pasojë, Gjykata vlerëson se çështja objekt shqyrtimi përfshihet në rrethin e çështjeve të juridiksionit kushtetues.

15. Në rastin në shqyrtim, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbartimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ai ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

16. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 28, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithashtu, Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave



normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese.*)

18. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhen analizuar të gjitha elementet e sipërcituar.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

19. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (12.3.2015) deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë 1-vjeçare. Gjykata çmon se një periudhë e tillë për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor (apo fillimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit) konsiderohet si një afat i paarsyeshëm.

ii) Kompleksiteti i çështjes

20. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese.*)

21. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt ekzekutimin e një vendimi gjyqësor nga Bashkia e Tiranës, e cila konsiston në vijimin e procedurave për regjistrimin e një objekti dhe të truallit funksional në posedim të kërkuarit. Bashkia e Tiranës, me shkresën nr. 6907/1 prot., datë 10.6.2015, ka

argumentuar se për vijimin e procedurave duhet të plotësohen kriteret kualifikuese të parashikuara në VKM-në nr. 608, datë 5.9.2012. Sipas Bashkisë Tiranë, bazuar në VKM-në e lartpërmendur, procedurat e regjistrimit mund të ndiqen vetëm për trojet funksionale që rezultojnë në pronësi të shtetit dhe jo ato me “pronar të pavërtetuar”, si në rastin e kërkuarit. Gjithashtu, në prapësimet me shkrim të paraqitura nga subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, rezulton se me urdhrin nr. 271, datë 25.2.2013 dhe urdhrin nr. 6301, datë 29.4.2014 është vendosur ngritja e grupeve të punës për zbatimin e VKM-së nr. 608, datë 5.9.2012, të cilat kanë si qëllim shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të depozituar nga individët sipas procedurës së përcaktuar në VKM-në e lartpërmendur. Në këtë drejtim, sipas Bashkisë Tiranë vetë kërkuari ka qenë pengesë në zbatimin e vendimit të formës së prerë, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave.

22. Gjykata vlerëson se këto argumente të subjektit të interesuar kanë qenë objekt i gjykimit të themelit dhe rezultojnë të jenë analizuar dhe zgjidhur tashmë nga një vendim gjyqësor, i cili nuk është ankimuar nga subjekti i interesuar. Për pasojë, Gjykata çmon se çështja nuk paraqitet komplekse, duke qenë se zgjidhja e problemit faktik, që lidhet me fillimin e procedurave për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk e bën çështjen komplekse në atë shkallë saqë të përbëjë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor.

23. Përderisa çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, Gjykata vëren se vlerësimi i sjelljes së kërkuarit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Sjellja e kërkuarit

24. Gjykata është shprehur se kohëzgjatja tej afateve të arsyeshme për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

25. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuari nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ndjekur rigorozisht të



gjitha veprimet e nevojshme juridike për të finalizuar të drejtën e tij të fituar gjyqësisht, duke iu drejtuar fillimisht vetë Bashkisë së Tiranës e pastaj përmbaruesit gjyqësor. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe duke shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

iv) Sjellja e autoriteteve

26. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje është e nevojshme të vlerësohet nëse shoqëria përmbarimore dhe Bashkia Tiranë kanë marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

27. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin

për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata çmon se përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka shfrytëzuar disa prej mjeteve procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pasi pas lajmërimeve për ekzekutimin vullnetar dhe të detyrueshëm nuk ka kryer asnjë veprim tjetër (të tilla si vendosje gjobe etj.). Këto veprime të përmbaruesit, gjithsesi, kanë rezultuar të pasuksesshme.

31. Për sa u përket veprimeve të palës debitore, Bashkisë Tiranë, ajo ka refuzuar të fillojë procedurat për regjistrimin e objektit dhe të truallit funksional në posedim të kërkuetit, që burojnë nga vendimi gjyqësor, me argumentin se kërkuesi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për vijimin e procedurave, i cili provon plotësimin e kushteve të kërkuara nga VKM-ja nr. 608, datë 5.9.2012. Pavarësisht këtij argumenti, Bashkia e Tiranës jo vetëm nuk ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin që kërkohet të ekzekutohet, por as veprimet përmbarimore. Për më tepër, sikurse u përmend më lart, kriteret e parashikuara nga VKM-ja në fjalë janë marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka arritur në përfundimin se është vetë subjekti i interesuar që ka shkelur përcaktimet e pikës 6/ç të VKM-së, pasi nuk ka përgatitur relacionin teknik, i cili përmban përshkrimin e hollësishëm për verifikimin e kryer dhe përgjigjen e specifikuar për çdo kush të përcaktuar në pikën 4 të VKM-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, punonjësit e Bashkisë Tiranë nuk kanë kryer asnjë verifikim në terren, por kanë konkluduar për mosplotësim të kushteve nga ana e kërkuetit pa përfunduar kryerjen e veprimeve që VKM-ja i ngarkon institucionit të autorizuar (Bashkisë).

32. Për sa më sipër, Gjykata çmon se Bashkia Tiranë duhet të merrte të gjitha masat, si dhe të gjente mjetet e duhura për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe jo të paraqiste arsye për ta penguar atë.

33. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë



brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 937, datë 25.2.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 46, datë 19.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.3.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 76/30 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Vath Çekrezi

Subjekte të interesuara: Tarik Llagami, Ferit Llagami, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Idajet Farka, Argjend Tafaj, Fatri Tafaj, Myhyrije

Verzivolli (Llagami), Adnan Llagami, Sadete Llagami, Adela Llagami, Mirnie Llagami, Aleksandra Llagami, Rezarta Bana, Fatbardha Pema (Bana), Demisha Bana, Naim Llagami, Zyhra Dibra, Nusret Llagami, Liliana Llagami, Mimoza Basha, Altin Llagami, Nezahet Hoxha, Razije Manehasa, Bukuriye Gjonaj, Letfije Llagami, Indrin Llagami, Andri Llagami, Emine Themeli, Enver Llagami, Ismail Farka, Marlind Farka, Idit Farka, Miriam Jaupi, Perihan Kalenja, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 12828, datë 20.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3980, datë 18.12.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42/1/2, 131/f, 134/1/g dhe 142/1/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkonte pranimin e kërkesës dhe pretendimet e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se në vitin 1999 kërkuar Vath Çekrezi është shpallur fitues i ankandit për privatizimin e objektit “Magazinë” në administrimin e Ndërmarrjes së Furnizim Komunikacioneve (NFK) Durrës. Me kontratën e shitjes të datës 9.2.1999 kërkuar ka blerë objektin nga NFK-ja Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP) me çmim 4.077.820 lekë. Objekti përbëhet nga katër pjesë të numërtuara 1, 2, 3 dhe 4. Kontrata midis palëve për objektin në tërësi është lidhur para noterit në datën 26.9.1999 me nr. 1093 rep., nr. 269 kol.



2. Pas blerjes së objektit të mësipërm, me anë të kontratës së shitjes nr. 946 rep., nr. 224 kol., datë 9.4.1999, NFK-ja Durrës i ka shitur kërkuesit një sipërfaqe truall 241 m², pronë e Parkut të Kamionëve, Tiranë. Me kontratën nr. 2898 rep., nr. 641 kol., datë 5.9.2001, AKP-ja i ka shitur kërkuesit edhe një sipërfaqe tjetër truall 379 m², si edhe i ka dhënë me qira një sipërfaqe truall 44 m².

3. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (KKKP-ja), me vendimin nr. 585, datë 29.7.1994, ka miratuar kërkesën e subjekteve të interesuara, trashëgimtarë të ish-pronarit Myhedin Llagami, për kthimin dhe kompensimin e pronës që përbëhet nga një truall i zënë me ndërtime shtetërore, si Ndërmarrja e Spedicionit S1, me sipërfaqe 450 m², Parku Automobilistik i Mallrave S2, me sipërfaqe 3428 m², në të cilën përfshihen disa objekte, si dhe Ofiçina e Ministrisë së Rendit Publik me sipërfaqe 5456 m², në të cilën përfshihen 12 objekte. Në bazë të këtij vendimi trashëgimtarëve të ish-pronarit Myhedin Llagami u është njohur dhe e drejta e parablerjes për truallin me përmasa 60x84 dhe sipërfaqe 5000 m², si dhe për truallin e zënë me ndërtime të përhershme me sipërfaqe 28.302 m². Vendimi është saktësuar me vendimin nr. 26, datë 17.5.1995 të KKKP-së Tiranë, duke iu kthyer fizikisht 2300 m² brenda sipërfaqes së njohur sipas vendimit nr. 585, datë 29.7.1994 të KKKP-së Tiranë.

4. KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. 321, datë 16.9.2000, ka vendosur t'i kthejë pronësinë trashëgimtarëve Llagami për truallin me sipërfaqe prej 8093 m², si dhe t'i njohë dhe t'i kthejë pronësinë për truallin dhe sheshin me sipërfaqe prej 27.613 m² me zbatimin e planit urbanistik të miratuar nga KRRT-ja Tiranë. Të gjitha sipërfaqet ndodhen brenda sipërfaqes prej 43.302 m² të njohur me vendimin nr. 585, datë 29.7.1994 të KKKP-së Tiranë.

5. Vendimi nr. 585, datë 29.7.1994 i KKKP-së, i plotësuar me vendimin nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së, është bërë objekt i shqyrtimit administrativ. Me vendimin nr. 200, datë 4.9.2007, drejtori i AKKP-së ka vendosur shfuqizimin e pikave 1 dhe 2 të vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së, që parashikonin kompensimin fizik të subjekteve të interesuara me një sipërfaqe tjetër truall dhe ndryshimin e

vendimit nr. 585, datë 29.7.1994 të KKKP-së, duke u njohur për këto sipërfaqe truall të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara në ligj.

6. Mbi ankimin e subjekteve të interesuara Tarik Llagami, Ferit Llagami etj.; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 364, datë 24.1.2008, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, anulimin tërësisht të aktit administrativ, vendimi nr. 200, datë 4.9.2007 të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Pasi vendimi ka marrë formë të prerë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit. Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2012-2700, datë 20.12.2012, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 15, datë 17.1.2014, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

8. Subjektet e interesuara në gjykimin kushtetues, në cilësinë e trashëgimtarëve të ish-pronarit, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave sipërcituara të lidhura ndërmjet kërkuesit, NFK-së dhe AKP-së.

9. Me vendimin nr. 12828, datë 20.12.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të datës 9.2.1999 e lidhur midis NFK- së Durrës, në cilësinë e shitësit dhe kërkuesit Vath Çekrezi në cilësinë e blerësit, për shitjen e objektit "Magazinë", me sipërfaqe 423.4 m² të ndodhur në Rrugën e Kavajës, Tiranë, si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nr. 1093/269 kol, datë 26.2.1999 të lidhur midis NFK-së Durrës, në cilësinë e shitësit dhe kërkuesit, në cilësinë e blerësit, për shitjen e objektit "Magazinë", të ndodhur në Rrugën e Kavajës, Tiranë, si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 946/224, datë 9.4.1999 të lidhur midis NFK-së Durrës, në cilësinë e shitësit dhe të paditurit Vath Çekrezi, në cilësinë e blerësit, për shitjen e truallit prej 241 m², të ndodhur në Rrugën e Kavajës Tiranë dhe



kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 2898/641, datë 5.9.2002 lidhur midis palës së paditur, AKP-së, në cilësinë e shitësit dhe të paditurit Vath Çekrezi, në cilësinë e blerësit, për shitjen e truallit me sipërfaqe 379 m² dhe dhënie me qira të truallit prej 44 m², të ndodhur në Rrugën e Kavajës, Tiranë, si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Çregjistrimin nga regjistri hipotekor nr. 485, datë 15.3.1999 të pasurive të paluajtshme nr. 6/61 dhe 6/62 të ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8250, nga emri i të paditurit Vath Çekrezi.”

10. Me vendimin nr. 3980, datë 18.12.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Me vendimin nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Vath Çekrezi.

II

12. **Kërkuesi Vath Çekrezi** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

12.1. Është cenuar parimi i paanësisë në gjykim. Gjyqtarët Z.P. dhe Z.S., të cilët kanë shqyrtuar çështjen në apel, kanë marrë pjesë edhe në gjykime të tjera të lidhura me çështjen objekt gjykimi. Konkretisht, gjyqtari Z.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykimin e çështjes civile me paditës kërkuesin dhe të paditur Bashkinë e Tiranës, që i përket vendimit nr. 2019, datë 4.11.2010. Ndërsa gjyqtarja Z.S. ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes penale që i përket vendimit nr. 122, datë 10.2.2014. Këto procese kanë lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në shqyrtim. Gjyqtarët edhe pse kishin dijeni për këto fakte, nuk kanë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes.

12.2. Parimi i paanësisë nuk është respektuar as në gjykimin në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari A.B., i cili ka qenë relator i çështjes, ka marrë pjesë më parë në gjykimin e një çështjeje tjetër me të njëjtët paditës për shfuqizimin e vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së, gjykim që ka përfunduar në favor të këtyre subjekteve me

vendimin nr. 364, datë 24.1.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12.3. Gjatë procesit gjyqësor nga gjykatat janë lejuar shkelje të rënda procedurale që lidhen me mënyrën e hartimit dhe të paraqitjes së kërkesë-padisë, parregullsi të njoftimeve, si edhe parregullsi në krijimin e ndër gjyqësisë. Në dosje ka munguar dëshmia e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin M.Ll. Edhe pse dëshmia është paraqitur për herë të parë në gjykim nga kërkuesi, duke kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor, gjykata e ka anashkuar këtë fakt. Po ashtu, gjykata nuk ka respektuar dispozitat procedurale që rregullojnë zëvendësimin procedural të palëve.

12.4. Gjykatat nuk kanë respektuar nenin 79/a të KPC-së, duke mos thirrur në gjykim Avokaturën e Shtetit për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e ish-pronarit shtet, i cili me ankand të rregullt ia ka shitur këtë pronë kërkuesit.

12.5 Gjykatat nuk kanë zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, në përputhje me nenin 14 të KPC-së, duke mos bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Ato nuk kanë vlerësuar në mënyrë objektive vendimet e KKKP-së të dhëna në favor të palës tjetër, gjë që ka çuar në cenimin e së drejtës së pronësisë së kërkuesit.

12.6 Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk rezulton të ketë marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave, por vetëm atë të paraqitur nga kërkuesi, veprime këto që janë bërë pa praninë e palëve dhe në një kohë tepër të shkurtër, 2 muaj.

12.7 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit, pasi nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara në rekurs. Gjithashtu, në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë mungon argumentimi i plotë ligjor për pavlefshmërinë absolute të secilën kontratë shitblerjeje të pronës.

13. **Subjektet e interesuara Tarik Llagami, Ferit Llagami, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Idajet Farka, Argjent Tafaj, Fatri Tafaj, Adnan Llagami, Sadete Llagami, Adela Llagami, Mirnie Llagami, Aleksandra Llagami, Rezarta Bana, Fatbardha Pema**



(Bana), Demisha Bana, Naim Llagami, Lumturije Llagami, Shpëtim Llagami, Sabina Llagami, Zyhra Dibra, Nusret Llagami, Liliana Llagami, Mimoza Basha, Altin Llagami, Nezahet Hoxha, Razije Manehasa, Bukurije Gjonaj, Letfije Llagami, Indrin Llagami, Andri Llagami, Emine Themeli, Enver Llagami, Ismail Farka, Marlind Farka, Idit Farka, Miriam Jaupi dhe Perihan Kalenja, kanë parashtruar me shkrim duke argumentuar si vijon:

13.1 Pretendimi për cenimin e parimit të paanësisë nga gjyqtarët Z.P. dhe Z.S. është i pabazuar. Këta gjyqtarë kanë marrë pjesë në gjykime të mëparshme, por në këto gjykime nuk kanë marrë në shqyrtim dhe nuk kanë vlerësuar fakte që kanë lidhje me thelbin dhe shkakun e çështjes civile objekt gjykimi.

13.2 I njëjti argumentim qëndron dhe për gjyqtarin A.B., i cili ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë këtij gjykimi ky gjyqtar nuk është shprehur në lidhje me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e vendimit nr. 321/2000 të KKKP-së. Pjesëmarrja e gjyqtarit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ndikon në paanshmërinë e tij për vlerësimin e pretendimeve të parashtruara në rekurs. Vlerësimi në dhomë këshillimi ka lidhje vetëm me verifikimin e shkaqeve të ngritura nga ana formale.

13.3 Pretendimi se nuk është marrë në shqyrtim rekursi i paraqitur nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në Ministrinë e Financave është i pabazuar. Fakti se ky subjekt ka paraqitur rekurs është pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë.

13.4 Pretendimi për mosthirrjen e Avokaturës së Shtetit në gjykim është i pabazuar. Njoftimi i këtij institucioni nga gjykata është bërë rregullisht dhe nuk është paraqitur nuk u zhvilluar gjykimi në mungesë. Në këtë formë ka shprehur qëndrimin e tij.

14. **Subjekti i interesuar, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

15. *Subjekti i interesuar, Drejtoria e Administrimit dhe Shtjtes së Pronës Publike*, nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuësit

16. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk kanë zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, se gjatë gjykimit ka pasur parregullsi që lidhen me mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së kërkesëpadisë, parregullsi të njoftimeve dhe parregullsi në krijimin e ndërgjyqësisë, për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale që rregullojnë zëvendësimin procedural të palëve, si edhe për shkak të mosthirrjes në gjykim të Avokaturës së Shtetit. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të arsytimit të vendimit dhe të parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit nga gjykatat e zakonshme dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

18. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuësit që lidhet me zhvillimin e hetimit gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm ka të bëjë me zbatimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve nga gjykatat e zakonshme, e si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Lidhur me pretendimet për parregullsitë në formimin e ndërgjyqësish dhe mosrespektimin e dispozitave procedurale që rregullojnë zëvendësimin procedural të palëve, Gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës kërkuesi, si subjekt i kushtëzuar, i parashikuar në pikën 1/g të po këtij neni mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si edhe duhet të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.

19. Për sa më sipër, Gjykata vëren se për sa kohë që kërkuesi parashtron pretendime që nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejt të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, ai nuk legjitimohet, pasi i mungon interesi vetjak për të ngritur këto pretendime.

20. Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuësit Vath Çekrezi duhet të shqyrtohet vetëm për



pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë gjatë gjykimit. Në vijim, Gjykata merr në shqyrtim pretendimin e kërkuarit.

B. Për themelin e çështjes, për pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë në gjykim

21. Kërkuari ka pretenduar se është cenuar parimi i paanësisë në gjykim. Sipas kërkuarit, gjyqtarët Z.P. dhe Z.S., të cilët kanë shqyrtuar çështjen në apel, kanë marrë pjesë edhe në gjykime të tjera që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi. Konkretisht, gjyqtari Z.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe në gjykimin e çështjes civile me paditës kërkuarin dhe të paditur Bashkinë Tiranë, që i përket vendimit nr. 2019, datë 4.11.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërsa gjyqtarja Z.S. ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes penale që i përket vendimit nr. 122, datë 10.2.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas tij, këto procese kanë lidhje të drejtpërdrejta me çështjen në shqyrtim. Gjyqtarët edhe pse kishin dijeni për këto fakte nuk kanë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes.

22. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar cenimin e parimit paanësisë edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas tij, gjyqtari A.B., anëtar i Kolegjit Civil, që ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, ka gjykuar një çështje tjetër civile me palë paditëse subjektet e interesuara në gjykimin kushtetues dhe të paditur AKKP-në Tiranë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 200, datë 4.9.2007 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarit A.B., me vendimin nr. 364, datë 24.1.2008, ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë.

23. Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Gjykata në jurispru-dencën e saj lidhur me standardet e parimit të paanësisë ka vlerësuar se fakti i pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dy gjykime të iniciuara nuk sjell apriori cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme, por i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore (*shih vendimin e nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin në shqyrtim, rezulton se gjyqtari Z.P. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykimin në apel të çështjes civile me paditës kërkuarin dhe të paditur Bashkinë Tiranë me objekt detyrimin e kësaj të fundit për shpërblimin e dëmit, si pasojë e prishjes së një pjese të magazinës në pronësi të kërkuarit, për efekt të rikonstruksionit të infrastrukturës së Rrugës së Kavajës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2019, datë 4.11.2010, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë lidhur me vlerën e shpërblimit.

25. Për sa i takon pretendimit për paanshmërinë e gjyqtarës Z.S., gjatë gjykimit në apel, rezulton se ka qenë pjesë e trupit gjykues për gjykimin e çështjes lidhur me pushimin e çështjes penale të regjistruar në bazë të kallëzimit të kërkuarit kundër trashëgimtarëve Llagami për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, konkretisht për falsifikimin e vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 122, datë 10.2.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të datës 15.11.2012, “Për pushimin e çështjes penale nr. 3809, viti 2012” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

26. Gjykata konstaton se çështjet ku kanë marrë pjesë gjyqtarët Z.S. dhe Z.P. janë çështje me palë, objekt e shkak ligjor të ndryshëm nga çështja objekt shqyrtimi në gjykimin kushtetues. Konkretisht, çështja ku ka marrë pjesë gjyqtari Z.P. ka si palë paditëse kërkuarin dhe të paditur Bashkinë Tiranë, objekt detyrimin e kësaj të fundit për shpërblimin e dëmit, si pasojë e prishjes së një pjese të magazinës në pronësi të kërkuarit, për efekt të rikonstruksionit të infrastrukturës së Rrugës së Kavajës. Vlerësimet që gjyqtari ka bërë në shqyrtimin e çështjes për shpërblimin e dëmit nuk janë të njëjta me ato të bëra në shqyrtimin e çështjes për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të kërkuarit. Çështja ku marrë pjesë gjyqtarja Z.S. lidhet me pushimin e çështjes penale të regjistruar në bazë të kallëzimit të kërkuarit kundër trashëgimtarëve Llagami për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, çështje me natyrë të ndryshme nga çështja konkrete. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të paanësisë nga gjyqtarët Z.P. dhe Z.S. është i pabazuar.



27. Për pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të paanësisë gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, Gjykata konstaton se bazuar në dosjen gjyqësore rezulton se gjyqtari A.B. ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, edhe çështjen civile me palë paditëse subjektet e interesuara dhe të paditur Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 200, datë 4.9.2007 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, Tiranë. Në përfundim të tij, me vendimin nr. 364, datë 24.1.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë duke shfuqizuar pikat 1 dhe 2 të vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së Tiranë. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit nr. 364, datë 24.1.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se çështja u përket të njëjtave prona objekt konflikti në çështjen në shqyrtim.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi

gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar i cili, në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se "...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (shih vendimin nr. 48, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese).

30. Gjykata konstaton se në çështjen konkrete vendimet gjyqësore objekt i gjykimit kushtetues kanë si objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitjes të lidhura mes kërkuesit, ish-NFK-së, Durrës dhe ish-AKP-së. Padia e subjekteve të interesuara është bazuar edhe në vendimin nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së Tiranë, i cili ka plotësuar vendimin nr. 585, datë 29.7.1994 të KKKP-së, vendime që iu njihnin të drejtën e parablerjes edhe për objekte të blera më parë prej kërkuesit. Me vendimin nr. 200, datë 4.9.2007 drejtori i AKKP-së ka vendosur shfuqizimin e pikave 1 dhe 2 të vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së, që parashikonin kompensimin fizik të subjekteve të interesuara me një sipërfaqe tjetër trualli dhe ndryshimin e vendimit nr. 585, datë 29.7.1994 të KKKP-së duke u njohur për këto sipërfaqe trualli të drejtën e kompensimit në një nga mënyrat e parashikuara në ligj.

31. Gjykata konstaton se gjyqtari A.B. ka gjykuar në themel çështjen lidhur me shfuqizimin e vendimi nr. 200, datë 4.9.2007 të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke vendosur shfuqizimin e këtij vendimi e për rrjedhojë konfirmimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 321, datë 16.9.2000 të KKKP-së Tiranë.

32. Gjykata, gjithashtu, konstaton se bazuar në materialet e dosjes subjektet e interesuara Ferik Llagami etj. i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar për shkak se zvarritja e mëtejshme e çështjes do të sillte dëm ekonomik. Në vijim të kësaj shkresë gjyqtari relator A.B., me shkresë drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është shprehur se "*çështja përfsihet në ato raste për t'u gjykuar*



me procedurë të përshpejtuar, për faktin se paditësi është njohur pronar mbi sipërfaqen objekt konflikti dhe për më tepër i është dhënë dhe e drejta e parablerjes së këtyre objekteve dhe zgjatja e mëtejshme e gjykimit do të bënte që subjektet e interesuara të humbasin të drejtat e fituara me vendim të KKKP-së”.

33. Gjykata, bazuar në rrethanat e mësipërme të çështjes konkrete dhe në standardet e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese për parimin e paanësisë, vlerëson se pjesëmarrja e gjyqtarit A.B. në dhënien e vendimit nr. 364, datë 24.1.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në dhënien e vendimit nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanësisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e testit objektiv të këtij parimi.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit Vath Çekrezi se Gjykata e Lartë gjatë gjykimit ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, në aspektin e parimit të paanësisë është i bazuar dhe se kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës².
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin mendim me shumicën për pranimin pjesërisht të kërkesës së paraqitur nga kërkuari Vath Çekrezi dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2015-2565, datë 16.7.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), vlerësojmë të paraqesim shkurtimisht argumentet për qëndrimin tonë në pakicë.

2. Sipas shumicës, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme për shkak të pjesëmarrjes në Kolegjin Civil, që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari, të gjyqtarit A.B., i cili ka gjykuar më parë si gjyqtar i vetëm një padi të paraqitur nga pala paditëse në proces me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 200, datë 4.9.2007 të drejtorit të AKP-së (vendimi nr. 364, datë 24.1.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

3. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë

² Gjyqtari Fatmir Hoxha ka qenë edhe për pranimin e pretendimit të cenimit të parimit të paanësisë nga gjyqtarja Z.S. gjatë gjykimit nga Gjykata e Apelit Tiranë.



rëndësie (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Gjykata ka vlerësuar se fakti i pjesëmarrjes së të njëjtit gjyqtar në dy gjykime të iniciuara nga kërkuesi nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme, por i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.4.2010*). Bazuar në nenin 72/4 të KPC-së, një nga rastet për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi është kur ai ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit. Kjo dispozitë kërkon përjashtimin e gjyqtarit që ndodhet në situatën kur i duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik që ka ndjekur tashmë në një gjykim të mëparshëm për të njëjtën çështje gjyqësore. Dyshimi i mundshëm për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt, pra në rastin kur gjyqtari ka manifestuar bindjen e tij në një shkallë tjetër të procesit.

5. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme vlerësojmë se në rastin konkret nuk është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim. Nga aktet e çështjes rezulton se në vendimin nr. 364, datë 24.1.2008, gjyqtari A.B. është ndalur në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, si edhe në elementet formale të aktit të kundërshtuar. Ai nuk ka bërë vlerësime që lidhen me konfliktin gjyqësor në fjalë apo me vlefshmërinë e titujve të kundërshtuar në procesin në fjalë. Me tej, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë procedurat e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, në dhomën e këshillimit verifikohet vetëm legjitimiteti i kërkuesit, bazueshmëria në ligj e rekursit, si dhe prania e kriterëve ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa në shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore shqyrtohet bazueshmëria e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, pra themeli i çështjes. Gjyqtarit që ka shqyrtuar në dhomë këshillimi nëse rekursi i paraqitur plotëson ose jo kriteret ligjore, nuk i duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik të ndjekur më parë prej tij gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore.

6. Në këtë kuptim, edhe pse çështjet konkrete ku ka marrë pjesë ky gjyqtar i referohen të njëjtës pronë dhe të njëjtave subjekte, vlerësimet që ai ka bërë në shqyrtimin e tyre nuk janë të njëjta. Gjykata, edhe pse ka theksuar se ajo e vlerëson respektimin e standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor rast pas rasti, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, në rastin në fjalë ajo ka vlerësuar *a priori* cenimin e këtij parimi, duke mbajtur një qëndrim formalist dhe pa mundur të argumentojë se cilat janë ato vlerësime të gjyqtarit të cilat shprehin qëndrimin e tij në lidhje me zgjidhjen e çështjes në fjalë dhe që e bëjnë atë të duket i njëanshëm në sytë e palëve në gjykim, pra se cilat janë ato veprime e sjellje konkrete të gjyqtarit që vënë në dyshim paanshmërinë e tij në gjykimin në fjalë.

7. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësojmë se kërkesa e paraqitur nga Vath Çekrezi është e pabazuar, për rrjedhojë Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e saj.

Anëtarë: Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 47, datë 22.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 3.6.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Neritan Tabaku

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Lartë i Drejtësisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 5, datë 12.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 30, 42, 131/f, 134/1/g, 134/2 dhe 147/6 të Kushtetutës së



Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Besnik Imeraj, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet e administruara në gjykim rezulton se në fund të vitit 2009 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) ka kryer kontroll në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën kohore 1.1.2009 dhe në vazhdim.

2. Në datën 8.3.2010 i është paraqitur KLD-së relacioni përkatës i inspektimit, sipas të cilit është konsideruar shkelje e disiplinës në punë mosdorëzimi i 60 dosjeve gjyqësore për shkak të mosarsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore, midis të cilave dhe dosja që i përkiste të gjykuarit I. Xh., relator i së cilës ishte gjyqtari Neritan Tabaku (kërkuesi).

3. Në datën 13.9.2012, në vendin e quajtur Katund i Ri, u vra shtetasi A.T. dhe personi i akuzuar për këtë veprë ishte shtetasi I.Xh. Në datën 19.9.2012 inspektorë të KLD-ja, pas verifikimeve të kryera, hartuan relacionin përkatës, duke rekomanduar fillimin e procedimit disiplinor për kërkuesin.

4. Me vendimin nr. 295/1, datë 5.10.2012 KLD-ja ka vendosur: “Miratimin e ndjekjes penale të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës Neritan Tabaku. Pezullimin e tij nga detyra e gjyqtarit derisa vendimi të marrë formë të prerë.”.

5. Me kërkesën nr. 6127/16, datë 26.10.2012, ministri i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra të gjyqtarit Neritan Tabaku”.

6. Me vendimin nr. 301/2, datë 7.12.2012 KLD-ja ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të gjyqtarit Neritan Tabaku për sjellje që diskre-

ditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, si dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.”.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, në mbështetje të nenit 147/6 të Kushtetutës.

8. Me vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë rrëzuar ankimin e kërkuarit Neritan Tabaku.

II

9. **Kërkuesi Neritan Tabaku** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këto shkaqe:

9.1 Është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve e kontradiktoritetit në procedimin disiplinor. Procedimi disiplinor është zhvilluar në mungesë të kërkuarit, edhe pse në mbledhjen e datës 7.12.2012 mbrojtësi i caktuar prej tij ka kërkuar shtyrjen, pasi kërkuesi ishte në pamundësi të paraqitej personalisht, sepse ishte i sëmurë, i shtruar në urgjencën e spitalit dhe ai nuk kishte tagra përfaqësimi për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor. Ishte detyrë e KLD-së të evidentonte dhe argumentonte shkakun e mosparaqitjes së kërkuarit dhe për sa kohë që ai ishte i ligjshëm dhe i arsyeshëm, nuk mund të zhvillonte seancën dhe të merrte masën e shkarkimit pa i krijuar mundësinë për t’u dëgjuar dhe për të zbatuar rregullat e kontradiktoritetit në gjykim. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Gjykata e Lartë, së cilës edhe pse iu paraqit si provë një vërtetim i datës 3.12.2013 se kërkuesi ka qenë i shtruar pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal Durrës, nuk e mori atë parasysh.

9.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike për shkak të parashkrimit të procedimit disiplinor. Për sa kohë që për të gjitha shkeljet e konstatuara në relacionin e datës 8.3.2010 nuk ishte ndër-marrë asnjë veprim, qartazi ato nuk mund të bëheshin më objekt kontrolli. KLD-ja në tejkallim të kompetencave të saj ka marrë në shqyrtim dhe ka konsideruar si shkelje veprime që ishin parashkruar dhe për të cilat nuk mund të vihej më në lëvizje procedimi disiplinor. Në respekt të parimit të sigurisë juridike ligji ka parashikuar disa afate me qëllim mbrojtjen e gjyqtarit dhe mosabuzimin me të nga organet e veshura me pushtet shtetëror. Procedimi i kërkuarit për



shkelje të kryera në një periudhë prej më shumë se 2 vjetësh është në kundërshtim me nenin 34 të ligjit nr. 9877/2008 dhe bie ndesh me parimet e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike.

9.3 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë në procedimin disiplinor, pasi kjo çështje është paragjykuar. Gjykimi administrativ jo vetëm është bërë në mungesë të subjektit në procedim apo të përfaqësuesit të tij (qoftë edhe të një përfaqësuesi të caktuar kryesisht), pa shkaqe të përligjura, por konkluzionin përfundimtar për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit KLD-ja e ka arritur duke u bazuar në fakte dhe rrethana që lidheshin me çështje e shkelje të pretenduara, të cilat nuk mund të merreshin më në shqyrtim për shkak të parashkrimit të tyre dhe nuk është bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete të rezultuara nga gjykimi.

9.4 Është cenuar parimi i pavarësisë, paprekshmërisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit, i sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës, pasi gjatë procedimit disiplinor nuk është verifikuar asnjë akt ose sjellje që diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit apo cenon në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor. Kërkesa për procedim dhe vetë vendimi i KLD-së janë haptazi të pabazuara në ligj dhe në fakt. Vonesa për shkaqe të jashtme, të arsyeshme, në arsyetim apo në dorëzimin e një apo disa dosjeve, përjashton dukshëm, qoftë dhe në formën e pretendimeve, elemente të kërkuara për përgjegjësinë disiplinore. Asnjëherë nuk është pretenduar që këto “vonesa” të kenë qenë të qëllimshme dhe asnjëherë nuk është vërtetuar që ato të kenë cenuar të drejta kushtetuese të shtetasve apo palëve në proces. Po ashtu, në kërkesën për procedim dhe relacionet që e shoqërojnë nuk janë pretenduar shkelje në lidhje me realizimin e drejtësisë, si detyrë themelore funksionale e kërkuarit.

9.5 Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit dhe nuk ka korrigjuar shkeljet e kryera nga KLD-ja gjatë procedimit administrativ. Vendimi i Gjykatës së Lartë është jologjik dhe ka kundërthënie të hapura. Nëse lexohet vendimi në tërësinë e tij Gjykata e Lartë herë konfirmon dhe herë rrëzon fakte të caktuara, shkelje të cilat janë referuar në çdo pretendim tjetër për cenimin e procesit të rregullt. Gjykata e Lartë arrin në përfundime të

cilat nuk janë bazuar në provat e administruara në gjykim dhe që nuk janë rrjedhë logjike e argumenteve të përdorura prej saj.

10. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka parashtruar:

10.1 Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes rezulton se KLD-ja ka caktuar 3 mbledhje për shqyrtimin e kësaj kërkesë, konkretisht në datat 15.11.2012, 30.11.2012 dhe 7.12.2012. Dy mbledhjet e para kanë dështuar dhe janë shtyrë për shkak të paraqitjes së raporteve shëndetësore nga gjyqtari Neritan Tabaku. Në mbledhjen e datës 7.12.2012 është paraqitur mbrojtësi i zgjedhur me prokurë të posaçme, i cili ka paraqitur kërkesë për pezullimin e procedimit administrativ deri në përfundimin e procedimit penal të gjyqtarit Neritan Tabaku. Kjo kërkesë është rrëzuar nga KLD-ja dhe pas kësaj ai është larguar duke deklaruar se nuk ka tagra përfaqësimi për të vijuar mbrojtjen për themelin e procedimit disiplinor. Në këto rrethana KLD-ja ka vijuar procedimin administrativ dhe pas marrjes së vendimit, ai i është njoftuar gjyqtarit me aktin nr. 2435, datë 28.12.2012.

10.2 Gjyqtari Neritan Tabaku ka marrë njoftim rregullisht mbi të gjitha momentet kyçe të procedimit administrativ disiplinor. Ai është njoftuar me aktin e datës 17.9.2012, nënshkruar personalisht prej tij në prani të dy inspektorëve. Me aktet nr. 6026/2 prot., datë 25.9.2012, nr. 6127/1 prot., datë 4.10.2012 dhe nr. 6026/4 prot., datë 8.10.2012 të Ministrisë së Drejtësisë atij i janë përcjellë rezultatet e verifikimit të Inspektoratit të KLD-së për të dyja procedurat e verifikimit, atë të vitit 2010 dhe atë të vitit 2012. Marrja e njoftimit të rregullt prej tij konfirmohet jo vetëm me aktet e mësipërme, por edhe me kërkesën me shkrim të paraqitur nga vetë gjyqtari dhe të regjistruar në KLD me nr. 2136 prot., datë 30.11.2012, si dhe me dy raportet mjekësore të datave 5.11.2012 dhe 27.11.2012. Gjyqtari Neritan Tabaku është njoftuar rregullisht me vendimin nr. 301/2, datë 7.12.2012 për dhënien e masës disiplinore ndaj tij. Nga sa më sipër rezulton se gjyqtari Neritan Tabaku ka marrë dijeni për procedimin disiplinor dhe me vullnetin e tij të lirë ka zgjedhur të mos marrë pjesë në të, të mos paraqesë prova mbi faktet dhe të mos



dëgjohej personalisht nga KLD-ja. Për pasojë, pretendimi i tij për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e njoftimit, të marrjes pjesë në procedim, të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, janë haptazi të pabazuara.

10.3 Procedimi disiplinor i zhvilluar nga KLD-ja nuk pengohet apo nuk pengon procedimin penal në ngarkim të këtij shtetasi dhe as kushtëzohet nga vazhdimësia ose jo e tij apo konkluzionet që mund të dalin nga ky hetim penal. Duke qenë një procedim disiplinor, ku janë marrë në shqyrtim shkeljet administrative të gjyqtarit (dhe jo fajësia e tij për një vepër penale të caktuar, e cila është atribut vetëm e procesit gjyqësor penal), ai është plotësisht në përputhje me Kushtetutën, ligjin organik të KLD-së dhe atë për organizimin e pushtetit gjyqësor. Për pasojë, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

10.4 Nga analiza e vendimit nr. 301/2, datë 7.12.2012 të KLD-së konstatohet lehtësisht se ai ka përmbushur të gjitha elementet e nevojshme formale të një vendimi të arsyetuar. Ai jep informacion mbi faktet që qëndrojnë në themel të procedimit, mbi procedurën e ndjekur, bën analizën e këtyre fakteve, duke i ballafaquar me legjislacionin e zbatuar, si dhe nxjerr konkluzione, duke u bazuar në dokumentacionin shkresor të marrë në shqyrtim nga KLD-ja. Për pasojë, edhe ky pretendim është i pabazuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

11. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Po ashtu, kërkuari legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej tij në kërkesë janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve të ngritura në kërkesë

12. Gjykata vëren se kërkuari ka kundërshtuar para saj si procesin administrativ të zhvilluar nga KLD-ja, ashtu edhe atë të zhvilluar nga Gjykata e Lartë. Sipas tij, në procedimin disiplinor është

cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve, për shkak të zhvillimit të procedimit në mungesë të tij, parimi i sigurisë juridike, për shkak të parashkrimit të procedimit disiplinor, parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi kjo çështje është paragykuar, parimi i pavarësisë, paprekshmërisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit, i sanksionuar në nenin 145 të Kushtetutës, për shkak se gjatë procedimit disiplinor nuk është verifikuar asnjë akt ose sjellje që diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit apo cenon në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor, si edhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor të vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili nuk u ka dhënë përgjigje pretë-ndimeve të ngritura prej tij dhe nuk ka korrigjuar shkeljet e kryera nga KLD-ja gjatë procedimit administrativ.

13. Gjykata, gjatë votimit të çështjes për këto pretendime, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë³, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendosi refuzimin e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, 134/1/g dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

³ Votuan për pranimin gjyqtarët: B. Dedja, G. Dizdari, B. Imeraj dhe F. Lulo. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: V. Kristo, S. Berberi, V. Tusha dhe F. Hoxha.



VENDIM
Nr. 48, datë 22.7.2016
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 2.6.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Marsel Nela

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 309, datë 27.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 09, datë 16.9.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-1066, datë 4.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuetit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 309, datë 27.12.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur të shpallë fajtor kërkuetin për kryerjen e veprës penale “Trafikim të femrave për prostitucion” dhe dënimin tij me 10 vite burgim dhe me gjobë.

2. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 487, datë 18.12.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 309, datë 27.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesën që i përket kërkuetit.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 527, datë 19.11.2008, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 487, datë 18.12.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 9, datë 16.9.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 309, datë 27.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1066, datë 4.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, ndërmjet të cilave edhe atë të paraqitur nga kërkueti.

II

6. **Kërkueti** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

6.1 Gjykata e Apelit në rigjykimin e çështjes nuk ka marrë parasysh detyrat e lëna nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 527, datë 19.11.2008. Ajo nuk ka verifikuar të gjitha pretendimet e të pandehurve për sa i takon sigurimit të provës dhe seancës së marrjes së provës.

6.2 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjyqtari Sh. S., pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe në gjykatën e shkallës të parë që ka dhënë vendimin nr. 309, datë 27.12.2005.

6.3 Është cenuar parimi për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të marra në mënyrë të paligjshme, për arsye se janë shkelur rregullat procedurale për sigurimin dhe marrjen e provës. Sipas kërkuetit, dëshmia është marrë pa u respektuar rregullat e njoftimit të palëve dhe pa u marrë parasysh pretendimet e avokatit të tij në lidhje me marrjen e dëshmisë nga e njëjta gjyqtare, e cila kishte pranuar kërkesën për sigurimin e provës.



7. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar si vijon:

7.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme është i bazuar, duke qenë se i njëjti gjyqtar që ka dhënë vendimin ndaj kërkuesit në gjykatën e shkallës së parë, ka marrë pjesë edhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi.

7.2 Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Apelit, në zbatim të detyrave të lëna nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka kryer të gjitha veprimet e mundshme procedurale në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm të çështjes.

7.3 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar. Kërkuesit i është dhënë mundësia të paraqesë mangësitë e provave përpara gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë mbështetur vendimet e tyre jo vetëm në provat e kundërshtuara nga kërkuesi, por edhe në një sërë provash të tjera. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjyqtarja K.Gj., e cila ka vendosur në lidhje me kërkesën për sigurimin e provës, nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e themelit të çështjes. Gjithashtu, avokati i kërkuesit ka marrë njoftim për kërkesën e prokurorisë për sigurimin e provës, njoftim të cilin e ka firmosur.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar këto pretendime të paraqitura nga kërkuesi.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme

10. Sipas kërkuesit është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjyqtari Sh. S., pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe në gjykatën e shkallës të parë që ka dhënë vendimin nr. 309, datë 27.12.2005.

11. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përleshur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi



gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në këndvështrimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 54, datë 20.7.2015; nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata në praktikë të vazhdueshme ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit, i cili ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues. Gjykatat duhet të jenë të kujdesshme dhe të marrin parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri objektive. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast, në shoqërinë demokratike, jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. Ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe *super partes* (*shih vendimet nr. 11, datë 5.4.2013; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në kushtet kur kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar se gjyqtari SH.S. ka pasur bindje personale ose interes në çështjen që ka ndikuar në vendimin e gjykatës, paanshmëria subjektive prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Nga rrethanat faktike rezulton se gjyqtari Sh. S. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykimin e çështjes në shkallë të parë që e ka deklaruar kërkuesin fajtor. Si pjesë e këtij trupit gjykues gjyqtari Sh.S. ka shqyrtuar dhe zgjidhur çështjen në themel, duke manifestuar bindjen e tij lidhur me fajësinë e kërkuesit. Ai ka qenë gjithashtu pjesë edhe e trupit gjykues që ka gjykuar rekursin në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë. Në këtë rast, si pjesë e trupit gjykues, ai ka vlerësuar në dhomë këshillimi ekzistencën e shkaqeve për të kaluar apo jo çështja për shqyrtim në seancë. Megjithatë edhe

pse si pjesë e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë gjyqtari SH.S. ka vlerësuar vetëm plotësimin ose jo të kërkesave ligjore për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata çmon se në rastin konkret ka vend për dyshime të arsyeshme dhe mjaftueshëm të bazuara, në drejtim të cenimit të paanshmërinë së gjykatës, në aspektin objektiv. Gjyqtari SH.S. ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes ndaj të njëjtit kërkues, të akuzuar për kryerjen e së njëjtës vepër penale, si në gjykatën e shkallës të parë, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë.

16. Për pasojë, Gjykata vlerëson se dyshimi i kërkuesit është i arsyeshëm dhe pretendimi i tij për cenimin e parimit të paanshmërisë, në aspektin objektiv, është i bazuar.

C. Për pretendimet e tjera të kërkuesit

17. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit në rigjykim nuk ka marrë parasysh detyrat dhe udhëzimet e lëna nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 527, datë 19.11.2008. Ajo nuk ka verifikuar të gjitha pretendimet e të pandehurve, nëpërmjet mbrojtësve të tyre, për sa i takon sigurimit të provës dhe seancës së marrjes së provës. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të marra në mënyrë të paligjshme, pasi janë shkelur rregullat procedurale për sigurimin dhe marrjen e provës. Sipas kërkuesit, dëshmia është marrë pa u respektuar rregullat e njoftimit të palëve, pa u marrë parasysh pretendimet e avokatit mbrojtës në lidhje me marrjen e dëshmisë nga e njëjta gjyqtare, e cila kishte pranuar kërkesën për sigurimin e provës.

18. Gjykata vlerëson të mos i analizojë këto pretendime në kushtet kur, për shkak të cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, çështja do të shqyrtohet përsëri në Gjykatën e Lartë. Referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit).



Gjykata nënvizon se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Si përfundim, për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, në aspektin objektiv, si një element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri⁴,

VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-1066, datë 4.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vetëm për sa i përket kërkuarit.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

VENDIM Nr. 49, datë 22.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 4.5.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 22 Akti që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Velaj” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Vangjel Kosta, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë, Spitali Rajonal Vlorë, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-721 (153), datë 25.2.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 30 dhe 81/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarës, që kërkoj pranimin e kërkesës dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarja është person juridik i regjistruar me vendimin nr. 34241, datë 27.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt

⁴ Gjyqtari V. Kristo votoi edhe për cenimin e së drejtës së ankimit në kuptimin substancial, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.



veprimtarie 'Ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private...', me seli në qytetin e Vlorës.

2. Në vitin 2006 shoqëria "Velaj" sh.p.k. ka lidhur një kontratë shërbimi me subjektin e interesuar, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Vlorë (në vijim "DRSHTRR, Vlorë"), sipas së cilës kërkesja do të kryente transportin e vlerave monetare fillimisht për një periudhë 1-vjeçare dhe më pas, sipas shtesës në kontratë, shërbimi do të shtrihej deri në datën 31.12.2007. Mbas datës 6.5.2008 kërkesja ka lidhur edhe një kontratë tjetër me DRSHTRR-në Vlorë, e cila ka zgjatur deri në vitin 2012.

3. Sipas kërkeses, shërbimet për subjektin e interesuar janë kryer pa kontratë të shkruar, por vetëm sipas marrëveshjes verbale, me qëllim shlyerjen sa më shpejt të detyrimit financiar. Në përfundim të kohës shtesë të kontratës, nga DRSHTRR-ja Vlorë është kërkuar që në mungesë të fondit kërkesja të vazhdonte kryerjen e shërbimeve, sepse objekti nuk mund të lihej pa roje dhe, po ashtu, vlerat monetare nuk mund të transportoheshin pa eskortë shoqërimi.

4. Kërkesja ka lidhur kontratë për ofrimin e të njëjtave shërbime si më sipër edhe me Spitalin Rajonal Vlorë për periudhën nga 15.5.2007 deri në 31.12.2007, kurse për periudhën nga 3.1.2008 deri 8.6.2008 palët nuk kanë lidhur kontratë me shkrim, meqenëse kanë rënë dakord verbalisht për zgjatjen e afatit të kontratës me të njëjtat kushte.

5. Me pretendimin se subjektet e interesuara nuk e kishin paguar për shërbimet e kryera, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt "Detyrimin e të paditurës, DRSHTRR-së Vlorë të paguajë shumën prej 1 022 280 lekësh të rinj; detyrimin e Spitalit Rajonal Vlorë të paguajë shumën prej 1 741 664 lekësh të rinj."

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2478, datë 14.10.2008, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkeses, me vendimin nr. 137, datë 13.5.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 2478, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt ka vendosur: "Detyrimin e së paditurës DRSHTRR, Vlorë t'i paguajë paditësit

shumën prej 1.126.736 lekësh; detyrimin e së paditurës Spitali Rajonal Vlorë t'i paguajë paditësit shumën prej 1.824.000 lekësh."

8. Subjekti i interesuar, DRSHTRR-ja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-721, datë 25.2.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 137, datë 13.5.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2478, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

II

9. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 29.1.2016 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

9.1 Është cenuar *e drejta e aksesit, si dhe parimi i kontradiktoritetit* gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, i cili është zhvilluar vetëm në prani të Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e palëve të paditura. Kolegji Administrativ nuk ka marrë masa për njoftimin individual të kërkeses (palë private), e cila ndryshe nga Avokatura e Shtetit (palë publike), me përfaqësi të përherëshme pranë Gjykatës së Lartë, nuk ka pasur mundësi të marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, kërkesja është vendosur në disavantazh, pasi nuk ka pasur mundësi të barabarta me palët e tjera për ballafaqimin e provave apo të opinionëve. Kolegji Administrativ ka gjykuar vetëm mbi pretendimet e palës rekursuese, pa i dhënë mundësi kërkeses të njihet me pretendimet dhe të shprehet në lidhje me to.

9.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, sepse Kolegji Administrativ është shprehur në dispozitiv edhe për ndryshimin e detyrimit të Spitalit Rajonal Vlorë, ndonëse kjo palë e paditur nuk kishte paraqitur rekurs. Edhe pse paditë janë bashkuar e gjykuar njëkohësisht, në disa raste bashkimi i gjykimeve nuk mund të mohojë ekzistencën e dy çështjeve të ndryshme e të pavarura nga njëra-tjetra, ku zgjidhja e njëres nuk kushtëzon zgjidhjen e tjetres. Kolegji Administrativ nuk ka mbajtur parasysh as qëndrimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka disponuar në



mënyrë individuale për detyrimin e secilës palë të paditur.

9.3 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, sepse ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, si vendim i formës së prerë, edhe për sa i takon detyrimin të Spitalit Rajonal Vlorë, në kushtet e mosparaqitjes së rekursit nga ajo palë e paditur, bie ndesh me pritshmëritë e ligjshme të kërkueses për moscenimin e të drejtave të fituara me vendim gjyqësor.

10. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka pretenduar rrëzimin e kërkesës, duke prapësuar në mënyrë të përmbledhur me shkrim si vijon:

10.1 Pretendimi për cenimin e aksesit në gjykatë dhe të parimit të kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore për njoftimin e palëve, duke i realizuar ato sipas rregullimeve përkatëse. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se rekursi i është komunikuar kërkueses, e cila nuk ka paraqitur kundërrekurs brenda afatit ligjor, sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit nr. 49/2012. Në këtë kuptim, kërkuësja ka pasur mundësi të paraqesë argumente dhe të mbrohet kundër pretendimeve të palës kundërshtarë.

10.2 Edhe pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar, për faktin se Kolegji Administrativ nuk ka marrë prova, por e ka shqyrtuar çështjen në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

10.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, sepse bazuar në shkakun e njëjtë ligjor dhe përputhshmërinë e plotë të themelit të pretendimeve në të dyja çështjet, ato janë bashkuar që në fillim të procesit gjyqësor, i cili ka ndjekur këtë logjikë deri në përfundimin e tij. Nga këndvështrimi i procesit të rregullt ligjor do të ishte e papranueshme që Kolegji Administrativ të mbante qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje, siç pretendon kërkuësja.

11. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë**, ka paraqitur me shkrim këto prapësime:

11.1 Pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për akses në gjykim është i pabazuar, pasi nga interpretimi gramatikor, logjik dhe sistematik i neneve 141 dhe 141/a të KPC-së, mbi

njoftimin e personave juridikë, del qartë se njoftimi përmes shpalljes, në rast se njoftimi dorazi nuk është i mundur, përbën një mënyrë ligjore dhe të përdorur nga gjykatat e të gjitha niveleve. Gjykata e Lartë nuk mund të vazhdojë pambarim përpjekjet për t'i dorëzuar personalisht njoftimin palëve, pasi kjo do të çonte në zvarritjen e procesit, duke cenuar shpejtësinë e tij.

11.2 Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj ai nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi argumentet e parashtruara nuk provojnë lidhjen midis mungesës së rekursit nga Spitali Rajonal Vlorë dhe cenimit të këtij aspekti të procesit të rregullt ligjor.

11.3 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi argumentet e kërkueses janë bazuar në interpretimin e gabuar të dispozitave procedurale, konkretisht të neneve 466/1 dhe 469 të KPC-së. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, që ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka qenë titull ekzekutiv që në momentin e marrjes së tij si në raport me DRSHTRR-në ashtu dhe me Spitalin Rajonal Vlorë.

12. **Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë**, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, pasi rekursi është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë pa praninë e palëve, duke respektuar afatet e parashikuara në ligj dhe procedurat e njoftimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

13. Gjykata paraprakisht konstaton se kërkuësja është person juridik dhe si i tillë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, ajo mund të jetë subjekt i të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar “*për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve*”, në kuptim të nenit 16/2 të Kushtetutës. Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t'i atribuohen një personi juridik, për shkak të thelbit të tyre ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Për sa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë



masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për të vlerësuar legjitimitimin e personave juridikë, Gjykata bazohet në të njëjtat elemente që merren në konsideratë për legjitimitimin e individëve, në referim të neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, kërkuesja, shoqëria “Velaj” sh.p.k., mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për çështje që lidhen me interesat e saj, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Kërkesat për shkëljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes, rregull ky i parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

15. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuesja i përmbush kriteret për legjitimitimin *ratione personae*, pasi pretendimet e saj përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar.

16. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkëljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 48, datë 6.7.2015; nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata Kushtetuese ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të

zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues. Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr. 2, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesja, shoqëria “Velaj” sh.p.k., nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ajo legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit, kontradiktoritetit, gjykatës së caktuar me ligj dhe sigurisë juridike, *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për akses dhe të parimit të kontradiktoritetit në Gjykatën e Lartë

18. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk ka marrë masa për njoftimin efektiv individual të saj si palë private, ndërkohë që Avokatura e Shtetit, palë publike dhe me përfaqësi të përhershme pranë Gjykatës së Lartë, ka pasur mundësi të marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor. Sipas kërkueses, si rezultat i mosnjoftimit asaj i është mohuar e drejta e ballafaqimit të provave apo të opinionëve me palët e tjera të pranishme, sepse Kolegji Administrativ ka gjykuar vetëm mbi pretendimet e palës rekursuese, pa i dhënë mundësi asaj të njihet me pretendimet dhe të shprehet në lidhje me to.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmang-



shme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendim-marrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 31, datë 26.5.2014; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, e bën procesin gjyqësor të cenueshëm. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet e argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të

cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se ka qenë vetëm subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Vlorë që ka paraqitur fillimisht rekurs të shkurtuar në datën 3.6.2009, kurse rekursi i plotë është depozituar në datën 15.7.2009. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. V-87prot., datë 17.7.2009, me lëndë “*Kthim rekurs?*”, ia ka kthyer kopjen e rekursit DRSHTRR-së, ndërkohë në shkresën e datës 22.7.2009 vërehet shënimi me shkrim dore “*t'i dërgohen aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*”. Në dosje gjendet edhe një shkresë e Gjykatës së Apelit Vlorë e datës 24.7.2009 me lëndë “*Dërgim rekurs?*” drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shënimin, midis të tjerash, “*Dosja është përcjellë në gjykatën tuaj në datën 13.7.2009*”. Nga dëftesa e komunikimit të rekursit e datës 19.8.2009 konstatohet se kërkesja ka marrë dizeni në datën 2.9.2009, shkresë e cila është nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

23. Gjykata, gjithashtu, vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen civile në dhomë këshillimi, në datën 30.6.2011 ka vendosur kalimin për gjykim të rekursit të paraqitur nga pala e paditur, DRSHTRR-ja. Çështja është gjykuar në seancë plenare publike në datën 25.2.2014 nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Sipas proces-verbalit të seancës gjyqësore konstatohet se kërkesja nuk është paraqitur, por “*ka dizeni me anë të shpalljes dhe shkak për mosparaqitje nuk ka*”, kurse dy subjektet e interesuara kanë qenë të përfaqësuara nga Avokatura e Shtetit, përfaqësuesi i së cilës ka lexuar dhe ka dorëzuar parashtresën me shkrim, që është administruar në dosjen gjyqësore. Në përfundim të procesit Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të Gjykatës së Shkallës së Parë.

24. Referuar rrethanave të çështjes, Gjykata konstaton se kuadri ligjor procedural, mbi bazën



e të cilit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin në dhomën e këshillimit, si dhe ka vendosur kalimin e tij për gjykim në seancë publike ka qenë Kodi i Procedurës Civile, i cili lidhur me njoftimin e palëve në nenin 482 parashikon se sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Ndërkohë, rekursi është gjykuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, sipas rregullave të parashikuara nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

25. Gjykata, referuar rrethanave të çështjes, vlerëson se në rastin konkret rregullat procedurale për njoftimin e palëve për gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë janë ato që përcakton neni 62 i ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit vendimi i Kolegjit për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe data e ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore, të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në vështrim sa më sipër, Gjykata çmon se jo vetëm për shkak të periudhës së gjatë kohore nga marrja dijeni për depozitimin e rekursit në zhvillimin e seancës publike (2009–2014), por veçanërisht duke marrë parasysh faktin se rekursi është marrë në shqyrtim sipas një kuadri të ndryshëm ligjor procedural, ka arsye për të arritur në përfundimin se Kolegji Administrativ nuk ka

marrë masat e nevojshme për t'i garantuar kërkuases të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, duke mos respektuar për rrjedhojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim.

28. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga subjekti i interesuar, DRSHTRR-ja, pa i dhënë mundësi konkrete efektive kërkuases që të paraqiste pretendimet e saja në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuases është i bazuar dhe kërkesa duhet të pranohet.

C. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimeve të gjykatës së caktuar me ligj dhe të sigurisë juridike

29. Kërkuessa ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara në nenin 63/b të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, sepse ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë edhe në pjesën që dispononte mbi detyrimin e Spitalit Rajonal Vlorë, pavarësisht mosparaqitjes së rekursit nga ky subjekt i interesuar. Për rrjedhojë, është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike, sepse vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë ishte i formës së prerë sa u takon të drejtave të fituara ndaj Spitalit Rajonal Vlorë.

30. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar



me ligj, nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursin për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtëm të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 17 datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs vetëm njëri nga subjektet e interesuara, konkretisht DRSHTRR-ja. Ky fakt konfirmohet edhe referuar përmbajtjes së vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, si dhe të Kolegjit Administrativ që ka gjykuar rekursin dhe ka vendosur prishjen e vendimit nr. 137, datë 13.5.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2487, datë 14.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

33. Bazuar në rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pavarësisht mosparaqitjes së rekursit nga Spitali Rajonal Vlorë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka shqyrtuar kryesisht, pra me nismën e vet, ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimit të ankimuar nga DRSHTRR-ja edhe ndaj situatës faktike e ligjore të subjektit të interesuar, Spitalit Rajonal Vlorë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

34. Po ashtu, Gjykata çmon të bazuar edhe pretendimin e kërkuar për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtëm të pritshmërive të ligjshme që kishte krijuar për të vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë. Jurisprudenca kushtetuese konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti i referon te parimi i shtetit

të së drejtës. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 20, datë 29.9.2008; nr. 38, datë 15.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata rithekson se në gjykimin kushtetues të kërkesave individuale, parimi i sigurisë juridike është vlerësuar në harmoni me parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padë kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 7 datë 10.2.2014; nr. 12 datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimit të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim (*shih vendimin nr. 77, datë 22.12.2015 Gjykatës Kushtetuese*).



36. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pavarësisht se Spitali Rajonal Vlorë nuk kishte paraqitur pretendime në lidhje me detyrimin financiar kundrejt kërkueses, ka krijuar pasoja të tilla që e vendosin atë (kërkuesen) në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike.

37. Për arsyet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se procesi i zhvilluar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-721 (153), datë 25.2.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.⁵
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo

VENDIM
Nr. 154, datë 18.7.2016

**MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
PAGESËS VJETORE PËR LICENCË
KOMBËTARE TRANSMETIMI
NUMERIK TOKËSOR AUDIOVIZIV,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 4,
DATË 22.5.2013, “MBI MIRATIMIN E
PAGESAVE PËR LICENCË”**

Në mbështetje të nenit 25, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv nga 15, 800, 000 lekë në masën 9, 330, 000 lekë.

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala

⁵ Gjyqtarët S. Berberi dhe F. Lulo votuan për shfuqizimin e vendimit vetëm për shkak të cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe kontradiktoritetit nga mosnjohimi efektiv, kurse gjyqtarja A. Xhoxhaj votoi për shfuqizimin e vendimit vetëm për shkak të mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë